



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.1488/6 Prot

Tiranë, më 02.11.2022

VENDIM

Nr. 43, datë 02.11.2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, administrator i kompanisë “Media Solution” (Boldnews.al), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1488 Prot., datë 01.09.2022, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Kërkuesi, z. , gazetar pranë agjencisë së lajmeve on-line “Boldnews.al”, nëpërmjet kërkesës datë 16.08.2022, depozituar në adresën elektronike [info@financa.gov.al](mailto:info@financa.gov.al) ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni, si më poshtë:

1. Listën e kompanive që kanë përfituar nga fondi i “Garancisë Sovrane” (përfshirë Paketat përkatëse), miratuar nga Qeveria Shqiptare për financimin e nevojshëm për rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar të ndikuar nga situata e krijuar nga Covid-19”
2. Informacioni të jepet, mundësisht, në formë tabelare, dhe të shoqërohet me të dhënat lidhur me:
  - Fondin e miratuar (alokuar) për secilën kompani?
  - Fondi i patërhequr nga secila kompani pas alokimit (nëse ka raste të tilla)?

- *Koha (data) kur është miratuar (alokuar) përfitimi i fondeve të Garancisë Sovrane për secilën kompani përfituese.*

Autoriteti Publik, nëpërmjet koordinatores për të drejtën e informimit me e-mail-in datë 29.08.2022, ka kthyer përgjigje duke refuzuar dhënien e informacionit me arsyetimin se “Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” përcakton në nenin 17, ndër të tjera, se: “E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: a) të drejtën për një jetë private; b) sekretin tregtar”.

*Mbështetur në sa më sipër, si dhe duke konsideruar faktin që kompanitë të cilat janë pjesë e skemave të Garancive Sovrane, nuk kanë dhënë pëlqimin paraprak për të publikuar emrin e tyre si kredimarrës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk mund të bëjë publike këtë listë.”*

Ankuesi, pas përgjigjes së sipërcituar, pretendon se: ““Garancia Sovrane” lidhet me financat publike, pra përbën interes publik dhe informacioni duhet të jetë publik”. Gjithashtu, “bazuar në nenin 3, pika 4 e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”: “Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t’i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji”. Informacioni i kërkuar nga “Boldnews.al” është i natyrës së njëjtë me atë që është kërkuar më parë dhe i është vendosur në dispozicion redaksisë “reporter.al” (BIRN) pas angazhimit të Komisionerit për Informim, referuar artikullit “Koncesionarët e qeverisë, përfituesit e mëdhenj të fondit të garancisë sovrane”, publikuar në datë 08.07.2020, sipas linkut <https://www.reporter.al/2020/07/08/koncesionarët-e-qeverisë-perfituesit-e-mëdhenj-te-fondit-te-garancise-sovrane/>”.

Ndodhur në këto kushte, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit/dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 1488/1 prot., datë 07.09.2022, ka kërkuar qëndrimin e Autoritetit Publik, në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, me e-mail-in datë 16.09.2022, ka kthyer përgjigje duke sqaruar ndër të tjera se: “Lista e kompanive që ka përfituar nga fondit i Garancisë Shtetërore, miratuar

*nga Qeveria Shqiptare nuk mund të vihet në dispozicion të kërkuarit për arsyet që janë dhënë në përgjigjen e parë. Gjithashtu, ju vëmë në dijeni se ka një kontratë kredie mes subjektit që ka përfituar kredinë dhe bankës së nivelit të dytë, e cila ruan sekretin bankar dhe konfidencialitetin e subjektit. Duhet miratimi i subjektit gjithashtu dhe i bankës që kjo listë të bëhet publike.*

*Për këtë ju mund ti drejtoheni bankave të nivelit të dytë ose Bankës së Shqipërisë.*

*Në lidhje me listën e vënë në dispozicion nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për redaksinë “Reporter.al” në vitin 2020, nga ana e Koordinatorit për të drejtën e Informimit nuk ka dalë ky informacion”.*

Pas refuzimit të dhënies së informacionit nga ana e Autoritetit Publik, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në të cilin parashikohet se: “...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri çmoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 05.10.2022, në prani të përfaqësuesve të Autoritetit Publik, znj. Hega Ismaili, me detyrë koordinatorë për të drejtën e informimit pranë autoritetit publik dhe znj. Brikena Nastini, Drejtor në Drejtorinë e Strategjisë dhe Monitorimit të Borxhit.

Ndërsa, ankuesi me e-mail-in po të datës 05.10.2022, bëri me dije se nuk do të ishte pjesë e seancës dëgjimore, me arsyetimin se informacioni i kërkuar është publik dhe është vendosur në dispozicion më parë nga Autoriteti Publik për “Birn Albania”, pas ndërhyrjes së Komisionerit.

Gjatë seancës dëgjimore, znj. Hega Ismaili, në cilësinë e koordinatorës për të drejtën e informimit pranë autoritetit publik, rikonfirmoi qëndrimin e mbajtur sipas përgjigjeve të dhëna me e-mail të datës 29.08.2022 dhe datës 16.09.2022, për mosdhënien e informacionit të kërkuar, duke marrë dhe përgjegjësinë e trajtimit të praktikës.

Në vijim, ankuesi nëpërmjet e-mail-it regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr.1488/5 Prot., datë 28.10.2022, i qëndron ankimit, duke kërkuar përmbushjen e detyrimit për dhënien e informacionit të kërkuar.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga ana e Autoritetit Publik në kthim përgjigjet me e-mail, konfirmuar edhe gjatë seancës dëgjimore, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI, si dhe Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, (në vijim, “Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”).

Bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: “Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet

*e njësisive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.*

Në kuptim të këtij parashikimi, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e “prodhuesit” apo “mbajtësit” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.*

Nga shqyrtimi i çështjes, konstatohet se objekti i kërkesës për informacion lidhet me politikën financiare që Qeveria Shqiptare ndërmori për rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar si pasojë e situatës së krijuar nga Covid-19, konkretisht mbi bizneset dhe kompanitë që përfituan nga Fondi i Garancisë Sovrane.

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga Autoriteti Publik se, *“... LDI përcakton në nenin 17, ndër të tjera, se: “E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: a) të drejtën për një jetë private; b) sekretin tregtar ”,* Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Në përgjigjen e dhënë, konstatohet se Autoriteti Publik, në argumentin e parashtruar për mos dhënie të informacionit, ka vendosur një nga rastet kur e drejta për informim kufizohet, por në rastin konkret ky i fundit, nuk ka bërë një analizë të mirëfildtë apo të argumentojë se si kjo e drejtë kufizohet, kur është e domosdoshme, proporcionale, si dhe dëmin që mund t’u shkaktojë bizneseve/kompanive si pasojë e dhënies së informacionit të kërkuar.

Po ashtu bazuar, në pikën 1, të nenit 3, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, parashikon: *“Të dhëna personale” është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.* Në këtë kuadër, emrat e subjekteve tregtare të regjistruar si person fizik ose juridik në bazë të legjislacionit përkatës tregtar, nuk konsiderohen si të dhëna personale dhe si të tilla nuk gëzojnë mbrojtje nga ky ligj.

Ndërkohë, në nenin 18 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, *“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”,* i ndryshuar, të cituar edhe nga Autoriteti Publik, konstatojmë se, në dispozitën përkatëse është përcaktuar qartë kufiri i sekretit tregtar, i cili përfshin vetëm informacionin e brendshëm. Megjithatë, në pikën 2 të nenit 18 të këtij ligji parashikohet se: *“2. Nuk përbën sekret tregtar informacioni, që duhet të bëhet publik në bazë të ligjit, që lidhet me shkëlqjen e ligjit, apo që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare e parimeve të etikës tregtare. Përhapja e këtij informacioni vlerësohet e ligjshme, nëse nëpërmjet këtij akti synohet të mbrohet interesi publik”.*

Për rrjedhojë, Autoriteti Publik nuk mund të bazojë kufizimin e një të drejte kushtetuese, vetëm mbi argumentin se *Informacioni i kërkuar kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: a) të drejtën për një jetë private; b) sekretin tregtar.*

Për sa i përket argumentit të parashtruar nga Autoriteti Publik se *ka një kontratë kredie mes subjektit që ka përfituar kredinë dhe bankës së nivelit të dytë, e cila ruan sekretin bankar dhe konfidencialitetin e subjektit. Duhet miratimi i subjektit gjithashtu dhe i bankës që kjo listë të bëhet publike*, Komisioneri vlerëson se ky argument nuk qëndron. Autoriteti Publik në argumentin e parashtruar, ka përmendur sekretin bankar dhe konfidencialitetin e subjektit, të dhëna të cilat gjenerohen në një kontratë kredie e lidhur midis Bankës së Nivelit të Dytë dhe subjektit përfitues, por nuk argumenton rolin dhe përgjegjësitë e këtij Autoriteti Publik në këtë marrëdhënie, duke e konsideruar atë si private dhe konfidenciale ndërmjet bankës dhe huamarrësit.

Konkretisht, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 6.4.2020 *“Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat e nivelit të dytë për pagat e tregtarëve ose shoqërive tregtare, aktiviteti i të cilave është prekur nga vendimet e këshillit të ministrave, në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga Covid-19, si edhe për përcaktimin e kushteve e të kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”*, është alokuar skema e parë e përfitimit, ku nëpërmjet Marrëveshjes së Garancisë Tip janë përcaktuar kushtet dhe kriteret e përfitimit të huasë. Në preambul të Marrëveshjes së Garancisë Tip përcaktohet se *“Kjo marrëveshje garancie (“Marrëveshja e Garancisë”) e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (“MFE”) dhe [Bankës XYZ] (“Huadhënësi”), bëhet për të përcaktuar kushtet e pjesëmarrjes së Huadhënësit në këtë skemë garancie të administruar nga MFE.*

*Marrëveshja e Garancisë nuk përbën detyrim të drejtpërdrejtë për shtetin (në këtë Marrëveshje përfaqësuar nga MFE), por përfaqëson një detyrim të mundshëm të tij. Ky detyrim kthehet në detyrim të drejtpërdrejtë në rastin kur përfituesi i drejtpërdrejtë i huasë (“Huamarrësi”) nuk ka arritur të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huanë e garantuar (“Huaja”), në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë (“Marrëveshja e Huasë”).”*

Në pikën 1 dhe pikën 2 të nenit 2, *“Garancia” të kësaj marrëveshje përcaktohet se: 1. MFE merr përsipër të garantojë Huadhënësin deri në shumën [xxxxxxx] Lekë. Kjo shumë përfaqëson shumën maksimale të pagesave që do të kryhen nga MFE për të shlyer detyrimet e papaguara ndaj Huadhënësit që burojnë nga Huatë që do t’i nështrohen kësaj skeme garancie; 2. MFE merr përsipër të garantojë deri në shumën e cituar në pikën 1 të këtij neni, 100% principalin e Huave, të cilat Huadhënësi do t’u lëvrojë Huamarrësve sipas kushteve që pasojnë në këtë Marrëveshje”*.

Po ashtu, në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 6 të saj *“Procedurat për kryerjen e pagesave të garancisë”* përcaktohet se: *1. Kur Huamarrësi nuk ka mundur të kryej pagesën e detyrimeve në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në Marrëveshjen e Huasë dhe kur Huadhënësi brenda një periudhë jo më pak se 120 ditë (nga dita e parë e mos*

pagesë së detyrimit nga Huamarrësi) ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e detyrimeve në përputhje me procedurat dhe praktikën e sektorit bankar, atehere Huadhënësi rezervon të drejtën për t'i dërguar MFE-së kërkesën me shkrim për pagesën e detyrimeve ("Kërkesa për Pagesë") të Huave që i nënshtrohen kësaj Marrëveshjeje.

2. Kërkesa për Pagesë që Huadhënësi do t'i drejtojë MFE-së duhet të përmbajë: a) Një përshkrim të detajuar të shumës që kërkohet, duke përcaktuar në mënyrë analitike principalin, interesat e akumuluar, penalitetet, si dhe çdo shpenzim tjetër të kryer në zbatim të Marrëveshjes së Huasë dhe që është në ngarkim të Huamarrësit, pavarësisht faktit që garancia mbulon vetëm detyrimin e principalit të Huasë. b) Një përshkrim të gjithë procedurave të ndjekura nga Huadhënësi përgjatë periudhës 120 ditore për të recuperuar detyrimet nga Huamarrësi nga momenti i gjenerimit të detyrimit deri në momentin e dërgimit të Kërkesës për Pagesë. c) Numrin e llogarisë bankare në të cilin do të kryhet pagesa nga MFE.

3. MFE, pasi vëren se Kërkesa për Pagesë është në përputhje me Pikën 2 të këtij Neni dhe kushtet që bëjnë të nevojshme paraqitjen e një kërkesë të tillë sipas përcaktimeve të Marrëveshjes së Huasë, autorizon transfertën e pagesës ose pagesave për Huadhënësin brenda 15 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës për pagesë.

Referuar dispozitave të sipërcituara, Komisioneri vlerëson se edhe pse roli i Autoritetit Publik nuk është i drejtpërdrejtë në huadhënie, të realizuar ndërmjet bankës dhe subjektit përfitues, në marrëveshjen e huasë të lidhur midis MFE dhe Bankës së Nivelit të Dytë ai ka marrë rolin e Garantorit në termat bankar, i cili në momentin kur huamarrësi nuk ka arritur të paguajë, tërësisht apo pjesërisht, huanë e garantuar në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në marrëveshjen e huasë, ka detyrimin e drejtpërdrejtë të shlyejë detyrimet e pa paguar, sipas pikës 3 të nenit 6 të dispozitës së sipërcituar, shlyerje e cila bëhet nga financat publike.

Gjithashtu, në vijim, të analizës së sipërcituar, bazuar në pikën 9 të nenit 4 "Detyrimet e Huadhënësit" përcaktohet se: "Huadhënësi do të vendos në dispozicion të MFE, me kërkesë të kësaj të fundit, kopje të dosjeve, të ekstrakteve, të dokumenteve, të rekordeve dhe të shkresave të të gjitha Huave që i nënshtrohen kësaj Marrëveshjeje Garancie".

Bazuar në pikat 1 dhe 2 të nenit 8 "Raportimi dhe Monitorimi" përcaktohet se: "1. Huadhënësi çdo të hënë do të raportojë në formë elektronike pranë MFE-së (ose strukturës që do të autorizoj MFE-në për këtë qëllim) për Huatë e aprovuara prej tij në javën paraardhëse, duke përcjellë shumën e disbursuar dhe skedulën e amortizimit të Huave, si edhe kopje të dokumentave shoqëruese që vërtetojnë Kriteret e Kualifikimit të Huamarrësve. 2. Huadhënësi gjithashtu do të raportojë në formë elektronike dhe shkresore në bazë mujore pranë MF-së (ose strukturës që do të autorizoj MFE-në për këtë qëllim), jo më vonë se 15 ditë nga mbyllja e secilit muaj, ecurinë e shlyerjes së Huasë, duke përfshirë në raportim informacion në lidhje me pagesat e kryera të Huasë nga Huamarrësi dhe vlerën e mbetur të Huasë".

Në trajtimin e kësaj ankese, Zyra e Komisionerit i'u referua gjithashtu dhe legjislacionit të posaçëm, që rregullon huamarrjen shtetërore dhe garancitë shtetërore të huasë në

Republikën e Shqipërisë, konkretisht ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë ne Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Sipas këtij ligji, në nenin 3 të tij “Kuptimi i garancisë shtetërore të huasë” parashikohet se: “Garancia shtetërore e huasë është marrëveshja e lidhur me shkrim, e cila përmban rregulla për të drejtat dhe detyrimet e palëve, kushtet dhe mënyrat, sipas të cilave shteti është përgjegjës për detyrimet financiare të një huamarrësi, kur ai nuk arrin t'i paguajë ato në kohën dhe masën e duhur. Garancia është detyrimi për pagesën e detyrimit financiar të një personi juridik, në rast se pala, që mban përgjegjësinë kryesore për pagesën e detyrimit financiar, nuk ka arritur ta paguajë atë në kohën e duhur. Garancia shtetërore e huasë është shuma e përgjithshme e huave, për të cilat Ministri i Financave ka nënshkruar marrëveshje garancie në emër të Këshillit të Ministrave.”.

Në nenin 39 “Dokumentacioni i garancisë shtetërore të huasë” të ligjit të sipërcituar parashikohet: “Ministria e Financave është e detyruar të ruajë të gjitha marrëveshjet e huasë, marrëveshjet e garancisë dhe marrëveshjet e mirëkuptimit, të miratuara në bazë të këtij ligji. Ministria e Financave ka detyrim ligjor të marrë në dorëzim dhe të ruajë të gjitha dokumentet që ndodhen në ministritë dhe institucionet shtetërore, në bazë të të cilave janë dhënë garancitë shtetërore të huasë, huatë e të cilave janë ende të papaguara. Ministria e Financave mban të dhëna të veçanta përmbledhëse për garancitë shtetërore të huasë në regjistrin e garancive shtetërore të huasë, në përputhje me këtë ligj.”

Ndërkohë, në nenin 44 “Centralizimi i të dhënave” parashikohet “Ministri i Financave mbledh dhe administron të dhënat e plota dhe të sakta të të gjitha detyrimeve, që kanë të bëjnë me borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë. Të gjitha ministritë apo institucionet e tjera qendrore, të cilat kanë të dhëna të tilla, marrin masa për kalimin e tyre në Ministrinë e Financave.” Dhe në nenin 45 “Regjistrat shtetërorë të të dhënave”, parashikohet “Për administrimin e të dhënave për borxhin shtetëror dhe për garancitë shtetërore të huasë, Ministria e Financave krijon dy regjistra:

- a) regjistrin e borxhit shtetëror;
- b) regjistrin e garancive shtetërore të huasë.”.

Neni 47 parashikon se: “Regjistri i garancive shtetërore të huasë përmban informacion, sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e miratuar nga Ministri i Financave. Në këtë informacion përfshihen të dhënat e identifikimit të secilës garanci huaje, sipas huamarrësit, institucionit huadhënës, shumës së huasë, monedhës dhe gjendjes së huasë, të regjistruar çdo gjashtë muaj.

Huamarrësi depoziton pranë Ministrisë së Financave, në datën 15 të çdo muaji, informacionin e nevojshëm për gjendjen dhe lëvizjen e fondeve të huasë së garantuar. Regjistri i garancive shtetërore të huasë përditësohet, në mënyrë të vazhdueshme, nga Ministria e Financave dhe botohet një herë në tre muaj”.

Bazuar në dispozitat e sipërcituara, në ndryshim nga pretendimi i Autoritetit Publik ky i fundit, rezulton si administrator i të gjithë procesit në emër të Këshillit të Ministrave, ka detyrimin për ruajtjen e të gjithë marrëveshjeve të garancisë si dhe të gjithë dokumentet e tjera lidhur me këtë marrëveshje.

Për më tëpër, referuar nenit 47 të ligjit nr. 9665/2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë ne Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, një pjesë e informacionit të kërkuar duhet të përmbahet nga Regjistri i Garancive Shtetërore të Huasë, i cili përditësohet në mënyrë të vazhdueshme, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe botohet një herë në tre muaj.

Në kuptim të dispozitës ligjore, Autoriteti Publik duhet të kishte bërë publik informacionin objekt të ankesës në faqen zyrtare të institucionit në Programin e Transparencës, informacion i cili nuk rezultoi i vendosur.

Referuar dispozitave të sipërcituara dhe argumentave të parashtruar, Komisioneri vlerëson se informacioni i kërkuar, i cili lidhet me emrat e kompanive të cilët kanë përfituar nga të ardhurat publike, për përballimin e një situatë të vështirë të krijuar në vend, përbën interes për publikun, ndaj duhet të bëhet publik.

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “*informacion publik*” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, duke mbajtur në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI, ku përcaktohet se: “*Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim*”.

Në vijim, në nenin 3, pika 4 e LDI parashikohet se “*Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t’i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji*”.

Po ashtu, bazuar në pikat 1 dhe 2 të nenit 9 të LDI përcaktohet se: “*1. Autoriteti publik bën të mundur që informacioni, i cili i është dhënë të paktën një herë një kërkuar, të bëhet i disponueshëm në mënyrën më praktike të mundshme për të gjithë personat e tjerë që mund ta kërkojnë në të ardhmen.*”

*2. Kërkesat për informim për informacione të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve plotësohen jo më vonë se 3 ditë pune nga momenti i paraqitjes së kërkesës.”*

Për sa më sipër, Autoriteti Publik në përputhje me dispozitat e sipërcituara duhet të kishte trajtuar kërkesën për informacion, në kushtet kur informacioni i kërkuar është vendosur në dispozicion më parë nga Autoriteti Publik, pretendim i ngritur edhe nga ankuesi.

Gjithashtu, kërkuar/ankuesi është gazetar, i cili synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik.

Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen “*Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë*”, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të



dekurajojnë punonjësit e medias ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e “mbikëqyrësit shoqëror”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

Pas shqyrtimit në tërësi të provave, sa i përket përgjegjësisë për refuzimin e dhënies së informacionit, nga verifikimi i dokumentacionit administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, si dhe deklarimit në seancën dëgjimore të koordinatorës për marrjen e përgjegjësisë të trajtimit të ankesës, Komisioneri konstaton se, znj. Hega Ismaili, me detyrë Koordinatorë për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, ka refuzuar dhënien e informacionit/dokumentacionit duke mos përmbushur kompetencat e saj të parashikuara në nenin 10 të LDI, konkretisht, shkronja a) e pikës 2 përcakton se, *Koordinatori i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, sipas këtij ligji, duke u konsultuar me dokumentin origjinal ose duke marrë një kopje të tij.*

Në këto kushte, bazuar në shkronjën “a” të pikës 2 të nenit 18 të LDI, *refuzimi për dhënien e informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë e cila varion nga 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë deri në 300.000 (treqind mijë) Lekë.*

Bazuar në pikën 3 të nenit 19, të LDI, Koordinatori për të drejtën e informimit ka përgjegjësi administrative, sipas parashikimeve të këtij ligji, për kundërvajtjet administrative të parashikuara në shkronjën “a” të pikës 2, të nenit 18 të LDI.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Në këtë kontekst, në lidhje me të njëjtën objekt kërkesë për informacion, Zyra e Komisionerit ka krijuar një praktikë të konsoliduar përmes vendimmarrjeve për raste të ngjashme të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit 3 të LDI, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.*

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

## V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së z. \_\_\_\_\_, nr. 1488 Prot., datë 01.09.2022, ndaj Autoritetit Publik “Ministria e Financave dhe Ekonomisë”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 16.08.2022, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, konkretisht: (-1. *Listën e kompanive që kanë përfituar nga fondi i “Garancisë Sovrane” (përfshirë Paketat përkatëse), miratuar nga Qeveria Shqiptare për financimin e nevojshëm për rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar të ndikuar nga situata e krijuar nga Covid-19*”; 2. *Informacioni të jepet, mundësisht, në formë tabelare, dhe të shoqërohet me të dhënat lidhur me:*
  - *Fondin e miratuar (alokuar) për secilën kompani?*
  - *Fondi i patërhequr nga secila kompani pas alokimit (nëse ka raste të tilla)?*
  - *Koha (data) kur është miratuar (alokuar) përfitimi i fondeve të Garancisë Sovrane për secilën kompani përfituese), brenda datës 09.11.2022.*
3. Dënimin e znj. Hega Ismaili, me detyrë Koordinatorë për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me nenin 19, pika 2 dhe 3 e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjyba ekzekutohet nga Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse të Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Kundër vendimmarrjes në pikat 1, dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 3, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
6. Ky vendim u shpall sot në datë 02.11.2022.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**